

stemuan në Ferizaj/Uroševac. Ka qenë në përbërje të Brigadës së 243 të Mekanizuar. Në datën **17.06.1998**, Zorani gjendej në përbërje të autokolonës së UJ-së, e cila shkonte nga Suhareka/Suva Reka për në Shtime/Štimlje. Në afërsi të fshatit **Duhël/Dulje**, makina në të cilën gjendej ai u prish dhe Zorani me ushtarë të tjerë dolën për ta riparuar. Pasi e aftësuan makinën, ata nisën të hipnin në të dhe, në atë çast, Zorani e ka qëlluar një pushkë snajperi nga pylli i afërt. E ka dhënë shpirtin në rrugë për në spital. Zorani e kanë varrosur më 20. 06. 1998 në varrezat e Stançevcit.

Burimet: deklarata A.D, FDH-35232; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 12; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-88-17; KMKRF, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 383, 718; *Dnevnik od 17. do 23. juna*, Ilustrovana politika, num.2058, FDH-31078.

Sladjan (Milivoje) Mirić

(17.11.1973, serb nga komuna e Shtimes/Štimlje, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Sladani e ka kryer shkollën e mesme teknike, ndërkaq, më pas, edhe trajnimin për oficer police. Ka nisur nga puna në SPB-në e Ferizajt/Uroševac në vitin 1996. Pas fillimit të konflikteve në Kosovë, u pranua në NJPP. Ka qenë i angazhuar në sigurimin e rrugës Shtime/Štimlje - Prizren. E ka humbur jetën më **17.06.1998**, nga ora 18:15, në **Duhël/Dulje**, te e ashtuquajtura *Shtëpia e Pyltarit/Šumarska kuća*, kur pjesëtarë të UÇK-së hapën zjarr nga drejtimi i Suharekës/Suva Reka mbi autokolonën e makinave policore. Me këtë rast, Sladani e kanë plagosur rëndë dhe ai ka dhënë shpirt në rrugë për në spitalin e Prishtinës/Priština. E kanë varrosur në varrezat ortodokse në Shtime/Štimlje, më 19.06.1998.

Burimet: deklarata V.G, FDH-30956; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 45; *Dnevnik od 17. do 23. juna*, Ilustrovana politika, num. 2058, FDH-18837; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 383, 934; *Pripadnici Ministarstva unutrašnjih poslova - žrtve albanskog terorizma u 1998. godini*, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>; FDH-31078; FHP, *Haški tribunal, Sudenje*

je Slobodanu Miloševiću, III, 692; KMKRF, *Personat...*, FDH-10832.

Ilaz (Nebih) Vranovci

(21.04.1945, shqiptar nga fshati Tërrnje/Trnje, komuna e Suharekës/Suva Reka, pensionist, pesë fëmijë)

Para shkuarjes në pension, Ilazi punonte si polic. Situata në **Tërrnje/Trnje** ka qenë e qetë gjatë muajit qershor të vitit 1998, edhe pse në fshatrat përreth dëgjoreshin të shtëna. Në datën **22.06.1998**, nga ora 22:00, Ilazi me familjarë gjendeshin në shtëpi kur dëgjuan zhurmën e automobilit. I biri Blerimi doli jashtë. Një *mercedes* ishte parkuar në afërsi të shtëpisë. Blerimi e ka hapur kapinë dhe dy burra të panjohur dhe të maskuar kanë hyrë në shtëpi dhe i urdhëruan Ilazit të nisej me ta. Në gjuhën shqipe, u thanë familjarëve se do ta kthenin shpejt. Ilazin e kanë mbyllur në automobil dhe, më pas, u kthyen në shtëpi, e bastisën dhe i morën paratë dhe stolitë. Ditën e nesërme, vëllai i Ilazit, Ismeti, ka dëgjuar nga një komshiu se Ilazin e kishin vrarë dhe se trupi i tij gjendej në Mamushë/Mamuša [Prizren]. Po atë ditë, Ismeti shkoi në Mamushë/Mamuša dhe në rrugë e gjeti trupin e Ilazit. E kishin ekzekutuar me një plumb në ballë, ndërkaq në trup i vëreheshin gjurmët e keqtrajtimit fizik. Ismeti e ka bartur Ilazin në Tërrnje/Trnje, ku e varrosën po atë ditë në varrezat lokale.

Burimet: deklarata B.V, FDH-22781; *Dnevnik od 17. do 23. juna*, Ilustrovana politika, nr.2058, FDH-18837; AIS, *Zona...*, 57, FDH-16913; KMKRF, *Personat...*, FDH-10832; FHP, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu Miloševiću*, II, 68-0-681; FHP, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu Miloševiću*, II, 688.

Isuf (Zenel) Hoxha

(13.11.1938, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, pensionist, katër fëmijë)

Hajrullah (Ramadan) Gashi

(1.02.1950, shqiptar nga Prizreni/Prizren, kamerier, katër fëmijë)

Isufi dhe Hajrullahu kanë qenë miq. Hajrullahu me familje jetonin në Prizren, në rrugën *Božidar Gogić* 11. Isufi me familje